

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT
NDERMARRJA E SHERBIMEVE PUBLIKE,BASHKIA KORÇE

Date 24.07.2019

Për: *Shqerine, "I.D.K - KONSTRUKSION" SH.P.K me NIPT K51408016J adresa : Tirane Vore VORE Autostrada Tirane-Durres, Km.12, Rruga Zaja, Koder Berxulle, Nr.Pasurie 1014/3, ZK.1167.*

Procedura e prokurimit: **"Boje sinjalistike horizontale"**

Numri i referencës së procedurës/loti : **REF-20671-05-06-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *Kjo kontrate ka per qellim realizimin e furnizimit me boje sinjalistike horizontale.*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet):

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1. Shoqeria "SARK" SH.P.K, NIPT K52531415H me vleren:
1,648,500 (nje milion e gjashteqind e dyzete e tete mije e peseqind) leke
2. Shoqeria "SIGNS & ROAD SAFETY SOLUTIONS" SH.P.K, NIPT L62228020U me vleren:
1,697,250 (nje milion e gjashteqind e nentedhjete e shtate mije e dyqind e pesedhjete) leke
3. Shoqeria "DEUTSCHCOLOR" SH.A., NIPT L21326504J me vleren:
1,824,000 (nje milion e teteqind e njezete e kater mije) leke
4. Shoqeria "BOLT" SH.P.K., NIPT K91517011V me vleren:
2,010,750 (dy milion e dhjete mije e shtateqind e pesedhjete) leke
5. Shoqeria "I.D.K - KONSTRUKSION" SH.P.K., NIPT K51408016J me vleren:
2,041,800 (dy milion e dyzete e nje mije e teteqind) leke
6. Shoqeria "ELDA-VL" SH.P.K., NIPT K67106202W me vleren:
Pa oferte

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Shoqeria “SARK” SH.P.K per arsye se:

Operatori nuk ka paraqitur skeda teknike te bojes, skeda te sigurise se bojes dhe kataloge te saj ne kundershtim me kerkesat e dokumenteve standarte te tenderit kapaciteti teknik pika 3 e tij ku kerkohet: “Operatori ekonomik duhet te paraqese skeda teknike te bojes, skeda te sigurise se bojes dhe kataloge te saj”.

2. Shoqeria “SIGNS & ROAD SAFETY SOLUTIONS” SH.P.K, per arsye se:

Operatori nuk ka paraqitur kataloge te bojës ne kundershtim me kerkesat e dokumenteve standarte te tenderit kapaciteti teknik pika 3 e tij ku kerkohet: “Operatori ekonomik duhet te paraqese skeda teknike te bojes, skeda te sigurise se bojes dhe **kataloge** te saj”.

3. Shoqeria “DEUTSCHCOLOR” SH.A, per arsye se:

1.Në zbatim te detyrimeve te parashikuara ne nenin 45/1 te LPP dhe kriterëve te veçanta te kualifikimit te percaktuara ne dokumentet te tenderit, kerkohet mes te tjerave se operatori ekonomik duhet të dorëzojë:“c. *Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit sipas Shtojcës 5*”.

Operatori ekonomik ne zbatim te detyrimeve te LPP dhe kriterëve te vecanta te kualifikimit ka detyrimin te deklaroje per gjendjen gjyqesore te personit/ave në cilësinë e ***anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, dhe çdo personi qe ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik***, me qellim kryerjen nga ana e Autoriteti Kontraktor te verifikimeve ne regjistrin elektronik te gjendjes gjyqesore.

Nga operatori juaj ne shtojcen 5 ka paraqitur te dhenat vetem per Z. Gabriel Muça i cili nuk eshte administrator i shoqerise por vetem perfaqesues i saj me prokure dhe ne shtojcen 5 nuk jane deklaruar te dhenat per administratorin e shoqerise dhe anetaret e keshillit mbikqyres ne kundershtim me kriteret e veçanta te kualifikimit dhe parashikimeve te LPP.

2.Në ofertën e paraqitur nga ana juaj çmimi i percaktuar ne preventiv eshte 1,824,000 leke pa TVSH, vlere e cila nuk perputhet me çmimin total te ofertes se paraqitur nga ana juaj e cila eshte vleren 3,653,900, nje vlere e cila tejkalon fondin limit te procedures se prokurimit.

4. Shoqeria “BOLT” SH.P.K, per arsye se:

Operatori nuk ka paraqitur dokumenta qe vertetojne plotesimin e kriterëve te veçanta te kualifikimit te dokumenteve standarte te tenderit , kapaciteti teknik pika 3 e tij ku kerkohen:

“1. Furnizime të ngjashme me vlere 40% te fondit limit të realizuara gjatë tre viteve të fundit

Ne rast te pervojes te meparshme te realizuar me ente publike duhet te paraqitet kontrata shoqeruar me vertetimin per realizimin e sukseshem te kontrates ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. **Ne rast te pervojes te meparshme te realizuar me sektorin privat** duhet te paraqiten fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara”.

Kontrata me nr. 4834/3 te dates 27.07.2015 te lidhur me AK Komanden mbeshtetese, reparti ushtarak nr. 4001 objekt i se ciles eshte furnizimi me materiale per mirembajtje kazermash nuk eshte realizuar gjate 3 viteve te fundit si kerkohet ne dokumentet e tenderit.

Kontrata me nr. 4049/7 e dates 03.08.2016 e lidhur me AK Komanda e Forses Tokesore , Reparti ushtarak

1001, Zall-Herr Tirane, objekt i se ciles eshte blerje materiale kazermimi per mbeshtetjen e stervitjes joint Effort Biza 2016” nuk permban furnizime te ngjashme ne vleren 833,100 leke pa TVSH apo 40% te fondit limit te kerkuar ne kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik.

5. Shoqeria “ELDA-VL” SH.P.K., per arsye se:

Nuk eshte paraqitur oferte

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“I.D.K - KONSTRUKSION” SH.P.K.**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **2,041,800 (dy milion e dyzete e nje mije e teteqind) leke**

pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Ndermarrjes se Sherbimeve Publike, Bashkise Korçë** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të së këtij njoftimi, por jo me vone se 5 dite nga kërkesa per lidhjen e kontrates.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

*Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : **28.05.2019***

Ankesa: **PO, (Vendimi i KPP nr. 481/2019)**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ILIRJAN DINELLARI**